



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žulbe i Predstavke**

**Anr. 361/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Ajet Sallahut nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës së Votimit 2621d; 2604d; 2608d;2601d dhe 2609d në komunën e Vitisë, për shkak të mungesës të votave, në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** si e pa lejuar ankesa e Ajet Sallahut nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës së Votimit 2621d; 2604d; 2608d;2601d dhe 2609d në komunën e Vitisë, për shkak të mungesës të votave, në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.10.2019, Ajet Sallahut nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës së Votimit 2621d; 2604d; 2608d;2601d dhe 2609d, në komunën e Vitisë, me të cilin pretendon se kandidati i LDK-se për deputet, Drilon Pira dyshon në saktësinë e numërimit të votave në qendrat e votimit në Kabash 2621d; Beguncë 2604d; Radivojce 2608d; Gjinnazi Kuvendi i Lezhës 2601d; dhe në Gjylekar 2609d.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

**Ankesa është e pa lejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, në Qendrat e Votimit 2621d; 2604d; 2608d;2601d dhe 2609d, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultetit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre.

Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrahet ankesa është e parakohshme, ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultetit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së Ajet Sallahut nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultetit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Në momentin e publikimit të rezultetit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**A nr. 361/2019 më datën 10.10.2019**



**Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.**